



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 724/5 Prot.

Patos, më 22/04/2024

PROCESVERBALI I TAKIMIT 19 PRILL 2024

Vendi: "Fshati Gjinoqarë, Njësia Administrative Ruzhdie"

Ora e fillimit : 10 :00

Ora e mbarimit : 12: 30

Tema e Konsultimit: "Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 dhe 52 të ligjit me nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB-së nr. 80 datë 18.12.2023 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2025-2027 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2025".

Pjesëmarrës: Zv. Kryetare e Bashkisë znj. Ina Sauli, Kryetari i këshillit bashkiak z. Armand ahmeti Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos, Kyetarë të fshatrave të njësisë Ruzhdie, dhe rreth 25 banorë të njësisë administrative Ruzhdie.

Takimin hapet nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Armand Ahmetaj: – të nderuar pjesëmarrës më lejoni së pari t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim konsultativ me temë: "Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027". Sot me mua është dhe Zëvendës Kryetare e Bashkisë znj. Ina Sauli , Drejtore e financës znj. Mimoza Shtwmabari, dhe anëtarë të Këshillit të Bashkisë Patos. Ky takim i sotëm realizohet në zbatim të ligjit me nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ka për synim marrjen e kërkesave

prioritare për hartimin e buxhetit afatmesëm, ato kërkesa të cilat ju mendojnë se ka nevojë zona juaj e banimit dhe padiskutim që çdo kërkesë e juaja do të regjistrohet nga ana jonë, tani fjala është për ju



Kryetari i Këshillit të Bashkisë Patoš
z. Armand Ahmetaj

Dëgjësë Publike me temë :

“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Prill 2024

Kryetar i fshati Gjinoqarë z. Nuri Gllava: - si fillim dua t’i uroj suksese nën kryetares. Në prioritetet tona i kemi përsëritur në çdo takim dhe akoma nuk është bërë asgjë.



Kryetar i fshati Gjinoqarë

z. Nuri Gllava

Dëgjësë Publike me temë :

“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Prill 2024

Banor i njësisë Ruzhdie z. Belul Mucaj: – ne kërkojmë rrugë pasi nuk shkojmë dot as në shtëpi dhe as në tokë nuk shkojmë dot. Është 2024 dhe ne akoma nuk kemi ujë për të pirë. Gjithashtu kërkoj të ndërhyet në linjën ekzistuese për furnizim me energji elektrike.



Banor i njësisë Ruzhdie
z. Belul Mucaj

Dëgjësë Publike me temë :

“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.

Prill 2024

Kryetari i Këshillit të Bashkisë Patos z. Armand Ahmetaj: – patjetër që ne jemi në kontakt të vazhdueshëm por kjo është një procedurë ligjore që duhet zbatuar pastaj mund të lindin kërkesa të reja ndaj dhe ne nuk kemi ardhur vetëm por jemi me ekipin e bashkisë dhe drejtore e financës do të na thotë se çfarë është parashikuar në buxhetin e vitit 2024 për tu investuar në njësinë Ruzhdie

Kryetar i fshati Gjinoqar z. Nuri Gllava: - ju e dini që fshati ka shumë vështirësi dhe probleme por unë për Gjinoqarën do të them vetëm ato që jamë më të rëndësishmet dhe më jetike. Së pari kërkoj bga bashkia të ndërhyet për shtrimin e rrugëve të fshatit, të parashikohet shtrimi dhe hapja e rrugëve të reja për në parcelat e tokave bujqësore dhe ajo që është më e



**Kryetari i fshati Gjinoqar
z. Nuri Gllava**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.*

Prill 2024

rëndësishmja që kam kërkuar është azhormimi i tokave pasi nuk marrim dot certifikata pronësie. Gjithashtu në fshatin Gjinoqarë mungon totalisht kanalizimi i ujrave të zeza pasi tw gjitha familjet funksionojnë me gropa septike dhe padyshim që pastrimi i tyre wshte një kosto shtesë për banorët. Me vendosjen e ujësjellësit dhe investimet që bashkia mund të bëjë në rrugët e fshatit të shikohet mundësia qoftë edhe me Agjencinë e Shërbimeve Publike të bëhen kanalizime për KUZ pwr fshatin tonw.

Drejtore e financës znj. Mimoza Shtëmbari:– ky takim sot organizohet në kuadër të marrjes së kërkesave prioritare për hartimin e buxhetit afatmesëm. Lidhur me kërkesat e bëra në dëgjesat e vitit 2023 për investim në vitin aktual jemi në procedurë tenderimi ndërsa lidhur



**Drejtore e financës
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor
Afatmesëm 2025-2027”.*

Prill 2024

mbi ujësjellësin jemi në fazën përfundimtare të tij dhe me përfundimin e këtij investimi nga ana e qeverisë do të çojë edhe në zgjidhjen përfundimtare të furnizimit me ujë të popullatës në të gjithë territorin e bashkisë Patos. Ndonjë kërkesë për buxhetin?

Banor i njësisë Ruzhdie z. Qani Lamaj : - kërkojmë ndricim të qendrave të fshatit dhe të rrugëve kyesore të tyre.



**Banor i njësisë Ruzhdie
z. Qani Lamaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm
2025-2027”.*

Prill 2024

Drejtor Kabineti z. Arben Semanjaku:- linja elektrike nuk i takon bashkisë por OSSHE-së pasi është detyra e tyre funksionale për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik për abonentët pasi edhe kontratën ju e lidhni individualisht. Në kohën kur isha administrator injwsisw Zharrzës ne kemi ndërhyrë në sistemin rrugor por jo vetëm në shtrim të tyre por edhe me kanalizime dhe ndicim por do tw duhwt mirwkuptomi i tw gjithwve pwr prishjen e gardheve qw kanw ngushtuar rrugwt.

Kryetar i fshatit Siqueqë z. Myftar Soraj: - kërkoj të bëhet azhurnimi i tokave bjqësore. Gjithashtu kërkoj rehabilitimin e qendrës së fshatit si dhe shtrimin e rrugëve të fshatit në lagjet Xhepaj, Hasaj ,Mesutaj dhe rrugëve të parcelave



**Kryetar i fshatit Siqueqë
z. Myftar Soraj**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për
hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm
2025-2027”.*

Prill 2024

Kryetari i Këshilli të bashkisë z. Armand Ahmetaj : - po fshatrat e tjerë janë pajisur me certifikatë pronësie?

Drejtor i bujqësisë z. Orgest Golloshi: - bashkia nuk është institucioni i cili kryen procesin e azhormimit por ne i jemi drejtuar ASHK-së për vazhdimin e këtij procesi dhe sot vetëm fshati Siqecë ka mbetur i pazhornuar. Jemi në pritje të kthimit të përgjigjes nga ASHK-ja, ajo që është me e rëndësishme është fakti se procesi i azhormimit ka kaluar në fshatrat e tjerë ndërsa për procesin e certifikimit të pronave është një proces i cili inicohet nga vet qytetari

Banor i njësisë Ruzhdie z. Besnik Mesutaj: - Kërkoj vendosjen e koshave të plehrave dhe bashkia duhet të përcaktoj fond për pastrimin e varrezave publike



**Banor i njësisë Ruzhdie
z. Besnik Mesutaj**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin
e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-
2027”.*

Prill 2024

Kryetar i fshatit Ruzhdie z. Sako Myftaraj: - me pak lekë dhe me shumë vullnet këtu në njësi duhet mbylet shumë punë dhe ajo që duhet të bëni është shtrimi i rrugëve të fshatit dhe parcelave, kanalizime të ujrave të zeza dhe mirëmbajtje të varrezave



**Kryetar i fshatit Ruzhdie
z. Sako Myftaraj**

Dëgjesë Publike me temë :

*“Marrja e kërkesave prioritare për hartimin
e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-
2027”.*

Prill 2024

Zëvendës Kryetare e Bashkisë znj. Ina Sauli – unë dëgjova me vëmendje cdo kërkesë apo koment tuajin lidhur mbi marrjen e kërkesave prioritare për hartimin e buxhetit afatmesëm 2026-2027, nëse nuk keni gjë tjetër për të shtuar e deklaroj këtë takim konsultativ të mbyllur duke ju falenderuar për pjesëmarrjen tuaj dhe pagiskutim për cdo sygjërim të dhënë.

Konceptoi:
Koordinator i Konsultimit Publik
Suzana Hysenaj

Pranoi:
Sekretar i Këshillit
Refaela Xeba

Foto të dëgjesës publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”.



